

SHËNIME SHPJEGUESE

VITI 2019

Shoqëria "ALB-EDIL" SHPK, Tiranë

Nipt K81513046P

Hartimi i Pasqyrave Financiare është bërë duke u mbështetur në kërkesat e ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe në kërkesat e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Pasqyrat Financiare janë përpiluar në bazë të kostos fillestare në hyrje dhe në vazhdimësi me koston e amortizuar për aktivet afatgjata materiale, dhe me koston mesatare të ponderuar për inventarët. Parimi bazë për përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve është parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të ligjit me metodën e inventarit periodik.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivitet:

Totali i aktiveve është pasqyruar në bilanc në vlerën 1,188,263,197 lekë. Krahasuar me periudhën paraardhëse aktivet totale janë rritur me 287,984,374 lekë.

Aktivitet afatshkurtra janë në shumën 1,129,171,873 lekë dhe përbëhen nga:

- Mjetet monetare në vlerën 484,953 lekë, të cilat krahasuar me periudhën paraardhëse janë zvogëluar me 1,746,029 lekë.
- Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në shumën 930,431,453 lekë. Ky zë përbëhet nga vlera e situacione ndër vite të pallateve 639,326,155 lekë, vlera e situacioneve në vitin 2019 në shumën 223,006,413 lekë dhe klientë në shumën 68,098,885 lekë.
- Debitorë të tjerë për parapagime në shumën 7,980,495 lekë.
- Inventarë mallra në 31.12.2019 në vlerën 6,370,077 lekë.
- Zëri i shpenzimeve të parapaguara (shpenzime për tu shpërndarë) 183,904,895 lekë, të cilat përbëhen nga shpenzime për tu shpërndarë nga vitet e kaluara në shumën 55,512,752 lekë dhe shtesa 128,392,143 lekë nga viti 2019. Shtesa prej 128,392,143 lekë përbëhet nga shpenzime për taksa dhe tarifa vendore 116,349,132 lekë, shpenzime për shërbime projektimi dhe arkitekture ndërtesash 7,864,833 lekë, shpenzime për kërkime dhe studime 751,800 lekë, shpenzime për interesa kredie 2,731,595 lekë dhe shpenzime të tjera 694,783 lekë.

Aktivitet Afatgjata Materiale Neto në Bilanc paraqiten me shumën 59,091,324 lekë. Vlerësimi i tyre është bërë me kosto minus amortizim. Aktivitet Afatgjata të blera gjatë vitit 2019 janë në shumën 4,261,218 lekë. Gjendja në çelje të vitit 2019 me vlerë fillestare 55,740,782 lekë, shtuar gjatë vitit me 4,261,218 lekë. Është llogaritur amortizimi i vitit 2019 brenda normave të lejuara nga legjislacioni fiskal në shumën 151,172 lekë. Amortizimi i akumuluar paraqitet në shumën 759,504 lekë më 31.12.2018, pakësuar 0 lekë, shtuar për 151,172 lekë në vitin 2019. Amortizimin progresiv më 31.12.2019 në shumën 910,676 lekë. Vlera neto e aktiveve afatgjata materiale e pasqyruar në Bilanc është 59,091,324 lekë, si diferencë e vlerës totale të aktiveve afatgjata materiale me vlerë fillestare më 31.12.2019 në shumën 60,002,000 lekë, me amortizimin e akumuluar të tyre në vlerën 910,676 lekë.

Detyrimet :

Detyrimet afatshkurtra në bilanc në 31.12.2019 është paraqitur në shumën 1,002,209,574 lekë, në fillim të vitit gjendja e tyre ka qenë 725,733,503 lekë, janë rritur me 276,476,071 lekë. Detyrimet afatshkurtra përbëhen nga

-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në shumën 993,527,895 lekë, të cilat përbëhen nga parapagime për blerje apartamente banimi në shumën 779,491,056 lekë, të pagueshme ndaj furnitorëve për furnizimet e kryera 131,613,309 lekë, detyrimet ndaj punonjësve për paga dhe shpërblime 183,176 lekë dhe hua të tjera në shumën 82,240,354 lekë.

-Të pagueshme për detyrime tatimore në shumën 8,681,679 lekë, të cilat përbëhen nga detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 110,488 lekë, detyrimi për tatim fitimin 8,331,799 lekë, detyrimi për TVSH-në 228,157 lekë, detyrimi për tatimin në burim 6,750 lekë dhe detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale 4,485 lekë.

Kapitali dhe rezervat

Shuma e kapitalit dhe rezervave më 31.12.2019 është pasqyruar në shumën 186,053,623 lekë dhe krahasuar me periudhën paraardhëse është rritur me 11,508,303 lekë (kjo shumë përfaqëson fitimin neto të vitit 2019).


Kapitali aksioner më 31.12.2019 është 100,000 lekë, në të njëjtën vlerë ashtu si edhe vitin e kaluar.

Rezerva ligjore është në vlerën 357,254 lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar.

Shoqëria në vitin 2019 ka rezultuar me një fitim neto prej 11,508,303 lekë.

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve)

Kjo pasqyrë është përpiluar bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës së tyre.



Të ardhurat gjithsej janë në shumën 222,002,283 lekë dhe përbëhen nga të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit që operon shoqëria, në fushën e ndërtimit.

Shpenzimet gjithsej për vitin 2019 janë në shumën 208,463,103 lekë.

Zëri lënda e parë dhe materiale të konsumueshme ka shumën 197,534,926 lekë.

Shpenzimet e personelit janë në shumën 5,198,731 lekë dhe përbëhen nga shpenzimet për pagat dhe shpërblimet e personelit në vlerën 4,444,241 lekë dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në shumën 754,490 lekë.

Në zërin shpenzime konsumi dhe amortizimi është pasqyruar amortizimi i aktiveve të shoqërisë, i cili është llogaritur duke rënduar shpenzimet e vitit ushtrimor brenda normave të lejuara në shumën 151,172 lekë.

Në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi janë pasqyruar shpenzime në shumën 5,578,274 lekë, ku përfshihen shpenzime për interesa huaje 1,709,027 lekë, shpenzime për dieta 610,000 lekë, shpenzime qiraje 540,000 lekë, humbje nga përkthimet valutore 521,278 lekë, shpenzime për shërbimet bankare 376,628 lekë, shpenzime kontabiliteti 240,000 lekë, shpenzime postare dhe telekomunikimi 213,852 lekë, shpenzime për taksa dhe tarifa vendore 179,076 lekë, shpenzime për energji dhe ujë në shumën 156,009 lekë, si edhe shpenzime të tjera në shumën 1,032,404 lekë.

Në zërin Fitim/Humbja para tatimit është pasqyruar fitimi i vitit në shumën 13,539,180 lekë.

Tatimi mbi fitimin për vitin 2019 është 2,030,877 lekë.

Fitimi neto për vitin 2019 është 11,508,303 lekë.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare është bërë sipas metodës indirekte dhe sipas kërkesave të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit është bërë sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

HARTUESI

ADMINISTRATORI

Astut Zamboni



Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		53,570,000		0	53,570,000
2	Mjete transporti			3,689,400	0	3,689,400
3	Mobilje dhe pajisje zyre		653,931	425,985	0	1,079,916
4	Zyra		983,334		0	983,334
5	Pajisje informative		533,517	145,833	0	679,350
	TOTALI		55,740,782	4,261,218	-	60,045,830

Amortizimi A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		0	0		0
2	Mjete transporti					0
3	Mobilje dhe pajisje zyre		594,776	11,517		606,293
4	Zyra		78,090	19,428		97,518
5	Pajisje informative		86,638	120,227		206,865
	TOTALI		759,504	151,172	0	910,676

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		53,570,000	0	0	53,570,000
2	Mjete transporti		0	3,689,400	0	3,689,400
3	Mobilje dhe pajisje zyre		59,155	425,985	11,517	473,623
4	Zyra		905,244	0	19,428	885,816
5	Pajisje informative		446,879	145,833	120,227	472,485
	TOTALI		54,981,278	4,261,218	151,172	59,091,324

Administratori

Astrit Kamberi

Astrit Kamberi

